



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/193

Datë: 30.06.2014

Në mbështetje të Nenit 92 (paragrafi 4) dhe Nenit 93 (paragrafi 4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh ndarjen buxhetore vjetore për ndërtimin e Autostradës Prishtinë - Hani i Elezit, sipas Ligjit nr. 04/L-233 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014 (Gazeta Zyrtare, Nr. 1, 09 janar 2014) si dhe duke marrë parasysh Vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës (Vendimi 028, 2 qershor 2008) me të cilin miratohet propozimi i Qeverisë së Kosovës (sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 13/10 të datës 07.03.2008) për shpalljen hapësirës-trasesë, për ndërtimin e Autostradës Morinë - Merdare dhe Prishtinë-Hani i Elezit zonë me interes të veçantë publik në Kosovë, duke u bazuar në Nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive (Gazeta Zyrtare, nr.1 /18 prill 2011) dhe Nenin 19 të Rregullores nr. 09/2011 për Punë të Qeverisë së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 15/12 shtator 2011), duke u bazuar në opinionin e dhënë nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, (Protokoll KRPP-Nr. 80/2014 të 26.06.2014) në pajtim me Nenin 87 (paragrafi 2-2.8) të Ligjit Nr. 04/L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 18 / 19 shtator 2011), sipas propozimit të Rekomandimeve nga Komiteti Drejtues Ndërministror, për zhvillimin e Projektit "Rruga 6" (Autostrada Prishtinë-Hani i Elezit) (Komiteti i krijuar me Vendimin e Qeverisë nr. 06/78 të datës 12.06.2012), Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2014, mori:

V E N D I M

1. Qeveria përkrah rekomandimet e propozuara nga Komiteti Drejtues Ndërministror për ndërtimin e Autostradës Prishtinë - Hani i Elezit.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- të gjitha ministrive (ministrave);
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës;
- Arkivit të Qeverisë.